



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2020:070969
Datë: 30.04.2024
Numri i dokumentit: 05640875

C.nr.624/20

GJYKATA THEMELORE NË PEJË, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, me gjyqtaren Rajmonda Kurteshi, në çështjen juridike kontestimore të paditësit A.B., nga fshati P., Komuna Pejë, të cilin e përfaqëson Lulzim Balaj, avokat në Pejë, kundër të paditurve A.Sh. nga fshati P., Komuna Pejë, dhe Kompania Kosovare për Furnizim me Energji Elektrike – KESCO, nga Peja, baza juridike largimin e telave të rrymës, vlera e kontestit 4500 euro, jashtë seance me datën 30.04.2024 mori dhe përpiloi këtë:

A K T V E N D I M

I. NDËRPRITET PROCEDURA në këtë çështje kontestimore C.nr.624/20, për shkak të vdekjes së të paditurit A.Sh..

II. Procedura e ndërprerë do të vazhdojë kur trashëgimtarët e të paditurit e marrin përsipër procedurën, apo kur të njëjtit i thërret Gjykata që ta bëjnë këtë me propozimin e palës kundërshtare.

A r s y e t i m

Paditësi, përmes të autorizuarit të tij, në këtë gjykatë me datën 18.06.2020 kanë parashtruar padi ndaj këtu të paditurve A.Sh. nga fshati P., Komuna Pejë, dhe Kompania Kosovare për Furnizim me Energji Elektrike – KESCO, nga Peja, me bazë juridike largimin e telave të rrymës, vlera e kontestit 4500 euro.

Gjykata, sipas dispozitave ligjore të LPK, nga fletëkthesa e kthyer gjykatës, lidhur me dorëzimin e përgjigjes në padi të paditurit të dytë, nga posta ishte konstatuar se pala (këtu padituri i dytë A.Sh.) ka vdekur dhe familja refuzon pranimin.

Gjykata, me datën 11.04.2024, i është drejtuar Zyrës së Gjendjes Civile në Pejë, duke pasur parasysh faktin se gjykata nuk ka asnjë dëshmi materiale që mundë ta vërtetojë se i njëjti ka vdekur, ka kërkuar që të njoftohet Gjykata nëse i njëjti është i regjistruar në librin amë të të vdekurve apo nëse kanë njohuri se i njëjti jeton në ndonjë adresë tjetër.

Me datën 12.04.2024, Gjykatës i ka arritur njoftimi lidhur me kërkesën e bërë, përmes së cilës, në mes tjerash, ZGJC në Pejë, e ka njoftuar gjykatën se sipas të dhënave që kanë gjetur në sistemin e tyre me të dhënat e të paditurit A.Sh., figuron se i njëjti është i vdekur nga viti 31.01.2021, në Pejë, duke i bashkangjitur edhe certifikatën e vdekjes me numër të referencës 17/2021RV/17001, me numër rendor 158, e lëshuar me datën 11.04.2024, me ç'rast pas vlerësimit të njëjtës nga ana e gjykatës del se të dhënat e cekur si në certifikatën e vdekjes përputhen me të dhënat e cekura si në shkresat e lëndës për të paditurin në fjalë, meqë rast i njëjti ka vdekur me datën 31.01.2021.

Prandaj, gjykata pas vlerësimit të kësaj situatë, nxjerr përfundim se janë plotësuar kushte ligjore që të bëhet ndërprerja e procedurës në këtë kontest në kuptim të dispozitës së nenit 277 par. 1 pika a) të LPK-së, për shkak të vdekjes së të paditurit, sipas të cilit nen përcaktohet se *“Procesi gjyqësor ndërpritet kur pala ndërgjyqëse vdes ose humb gjyqësinë procedurale”*, i ndryshuar me nenin 18 të Ligji nr. 04/L-118 Për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-006 Për Procedurën Kontestimore.

Ndërsa me dispozitën e nenit 280 të LPK-së, thuhet se: *“Procedura që është ndërprerë për shkaqe të treguara në nenin 277 paragrafi 1 pika a) të këtij ligji do të vazhdohet kur trashëgimtari, apo kujdestari i pasurisë trashëgimore, përfaqësuesi i ri ligjore, administratori i falimentimit apo paraardhësi juridik i personit juridik, merr përsipër procedurën apo kur i thirret gjykata ta bëjnë këtë, me propozimin e palës kundërshtare”*.

Andaj duke marrë parasysh të lartcekurat, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi, e konform nenit 142, 277 pika (a) dhe nenit 387 pika e) të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK-së).

GJYKATA THEMELORE NË PEJË
Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil
C.nr.624/20, me datë 30.04.2024

Gjyqtarja,
Rajmonda Kurteshi

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa në afatin prej 15 ditëve, pas marrjes së të njëjtit, nëpërmjet kësaj gjykate, për Gjykatën e Apelit të Kosovës në Prishtinë.